

TERMAT E REFERENCËS

Pozicioni: Koordinator për Monitorim Institucional dhe Shkëmbim Eksperience

Institucioni përfitues: Agjencia Kombëtare e Rinisë (PP02), Shqipëri

Emri i projektit: HARMONY — Shëndeti dhe Qëndrueshmëria: Fuqizim Mendor për të Rinj

Kodi i projektit: 03C1055

Programi i financimit: Interreg Europe

Instrumenti i politikës i adresuar: Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029

Kohëzgjatja e projektit: 1 maj 2025 — 30 prill 2028

Data e fillimit të kontratës: 5 Shtator 2025

Data e përfundimit të kontratës: 30 prill 2028

Vendi i angazhimit: Tiranë, Shqipëri

Raporton te: Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Rinisë

1. Konteksti i projektit

Projekti **HARMONY Health and Resilience: Mental Empowerment for New Youth** është një nismë ndërrajonale e financuar nga Programi Interreg Europe, me qëllim të përmirësimit të politikave publike që lidhen me shëndetin mendor të të rinjve në nivel lokal dhe evropian. Duke pasur parasysh ndikimet e krizave shëndetësore dhe sociale të viteve të fundit, HARMONY adreson nevojën për qasje më të ndërgjegjshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ndaj shëndetit mendor të të rinjve, duke theksuar rolin e komunitetit, institucioneve publike dhe sektorit joformal.

Konsorciumi përbëhet nga dhjetë partnerë evropianë, përfshirë institucione publike, autoritete rajonale, organizata arsimore dhe institute kërkimore. **Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)** përfaqëson Shqipërinë si partner zbatues dhe fokusohet në analizimin e kontekstit politik vendor, mobilizimin e aktorëve institucionalë dhe shoqërorë, si dhe kontribuimin në përmirësimin e **Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029**, e cila është identifikuar si instrumenti politik që do të përfitojë nga rezultatet e projektit.

2. Qëllimi i pozicionit

Pozicioni i Koordinatorit për Monitorim Institucional dhe Shkëmbim Eksperience është krijuar për të mbështetur zbatimin përmbytësor të aktiviteteve të Projektit HARMONY në Shqipëri, duke u përqendruar veçanërisht në **Paketën e Punës 1 (WPI): Shkëmbimi i eksperiencave dhe përmirësimi i politikave**. Ky rol fokusohet në hartimin dhe ndjekjen e analizave të politikave rinore që lidhen me shëndetin mendor, koordinimin e grupeve

shumëpalëshe të interesit (institucione publike, shoqëri civile, ekspertë, të rinj), si dhe në përfaqësimin tematik të AKR-së në aktivitetet ndërkombëtare të projektit.

Koordinatori nuk përfshihet në menaxhimin financiar, raportimin e përgjithshëm apo aktivitetet e komunikimit publik të projektit, por bashkëpunon ngushtë me Menaxherin e Projektit dhe Specialistin e Komunikimit për të siguruar integrimin e përmbajtjes në rezultatet dhe raportimet e projektit.

3. Qetyra dhe përgjegjësi

- Bashkëpunon me Menaxherin e Projektit në përgatitjen dhe ndjekjen e planit të punës të Paketës së Punës 1 (WP1), duke respektuar afatet e përcaktuara dhe standardet e projektit.
- Harton analizën për situatën ekzistuese të politikave kombëtare që adresojnë shëndetin mendor të të rinjve, duke u bazuar në evidenca, praktika ekzistuese dhe burime legjislative.
- Organizimi dhe drejtimi i ciklit të takimeve me **grupin shumëpalësh të aktorëve kombëtarë (Playground)**, përfshirë institucione publike, organizata rinore, profesionistë të fushës dhe përfaqësues të vetë të rinjve.
- Përzgjedhja dhe dokumentimi i praktikave të mira që mund të ndahen me partnerët e tjerë evropianë, si dhe përgatitja e përshkrimeve dhe analizave shoqëruese.
- Ndjekja dhe përfaqësimi i AKR-së në aktivitetet ndërkombëtare me fokus

përmbajtësor (workshop-e, takime teknike, platforma virtuale), në përputhje me planin e projektit.

- Kontribut në përgatitjen e rekomandimeve për përmirësim të politikave në përputhje me rezultatet e analizës dhe konsultimeve kombëtare.
- Bashkëpunim me konsulentët tematikë për përgatitjen e inputeve që do të përdoren në raportet ndërkombëtare të projektit.
- Hartimi dhe dorëzimi i pjesëve përkatëse tematike në raportimet gjashtëmujore të projektit, në koordinim me Menaxherin e Projektit.

4. Kualifikime të kërkuara

- Diplomë universitare në një nga fushat e mëposhtme: Administrim Publik, Administrim Biznesi, Politika Publike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Sociologji, Studime Evropiane, apo fusha të ndërlidhura.
- Minimum **8 vite përvojë** profesionale në projekte të financuara nga Bashkimi Evropian ose organizata ndërkombëtare.
- Përvojë në hartimin e analizave politike, lehtësimin e platformave të konsultimit me aktorë institucionalë dhe përgatitjen e kontributeve për politika publike.

- Aftësi shumë të mira në analizë kontekstuale, përgatitje dokumentesh strategjike dhe komunikim profesional me grupe të ndryshme të interesit.
- Njohje të shkëlqyer të gjuhës shqipe dhe njohje e avancuar e gjuhës angleze.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur, me përgjegjësi dhe në përputhje me ritmin dhe kërkesat e një projekti ndërkombëtar.